

**PROGRAM ORIENTUES
PËR PËRGATITJEN E PROVIMIT KOMBËTAR
TË MATURËS SHETËRORE**

PËR ARSIMIN E MESËM

**NË LËNDËN:
GJUHA ANGLEZE**

VITI MËSIMOR 2008-2009

Tiranë, 2009

I. UDHËZUES I PËRGJITHSHËM MBI PROGRAMIN E PROVIMIT KOMBETAR TË MATURËS SHTETËRORE PËR LËNDËN E ANGLISHTES DHE MBI PËRDORIMIN E TIJ NGA MËSUESIT

Programi orientues për përgatitjen e maturës kombëtare i gjuhës angleze vjen si sintezë e njohurive dhe shprehive të fituara gjatë gjithë procesit mësimor në këtë lëndë, si në aspektin tematik ashtu edhe në aspektin gjuhësor (gramatikor, leksikor) dhe funksional.

Hartimi i këtij programi orientues është bazuar totalisht në kuadrin kurikular të gjuhëve të huaja duke pasur parasysh zhvillimin e aftësive gjuhësore që do të testohen, standartet e gjuhëve të huaja, programet e katër viteve të shkollës së mesme, tekstet me të cilat është zhvilluar gjuha angleze në shkollën e mesme si edhe përvojën e fituar nga matura shtetërore e vitit 2005-2006. Për hartimin e këtij programi u tërhoq mendimi dhe përvoja e mësuesve më të kualifikuar të gjuhës angleze për rrethin e Tiranës.

Ky program orientues synon:

- të ndihmojë nxënësin maturant për përgatitjen për provimin e gjuhës angleze si lëndë me zgjedhje.
- Të ndihmojë mësuesin e lëndës për t'ju dhënë orientimet e duhura nxënësve dhe për të punuar për zbatimin e programit.
- vlerësimin e njëkohshëm të 2 aftësive kryesore (nga katër aftësi që ka gjuha e huaj) që përbëjnë dhe **dy konceptet bazë**, që janë të kuptuarit dhe të shprehurit me shkrim.
- të japë orientime për mësuesit hartues të testeve të provimit të maturës shtetërore për gjuhën angleze si lëndë më zgjedhje.
- vlerësimin e të kuptuarit dhe të shprehurit me anë të strukturave gjuhësore bazë, në aspektin e tyre morfologjik, sintaksor, leksikor dhe funksional.
- aftësinë për të përdorur formimin gjuhësor në mënyrë të pavarur, në mënyrë korrekte dhe të përshtatshme me situata komunikimi të dhëna.

Udhëzime praktike mbi përdorimin e programit.

- Për përdorimin e këtij programi mësuesi duhet të ketë parasysh specifikën e gjuhës së huaj ku nxënësi në provim do të përballet me situata të reja ose me pjesë të reja leximi por tematika, gramatika dhe funksionet gjuhësore do të jenë po ato.
- Kur flitet për tematikën kryesore në program (p.sh:” Life of famous people”) kjo nuk do të thotë që në provim do të ketë pasazhe nga mësimet që ka në libër (p.sh Tina Turner, Paul Newman, Sting etj). Në provim do të dale jeta e nje figure tjetër të shquar në atë fushë. Kështu që mësuesi duhet t’i përgatisë nxënësit që të kenë njohuri dhe një bagazh të konsiderueshëm leksikor për temat që janë të përfshira në program.
- Përsa i përket gramatikës , mësuesi duhet të përgatisë nxënësit që të jenë në gjendje të zgjidhin ushtrime mbi një problem të caktuar gramatikor (passive voice, conditionals, reported speech, verb tenses’ combinations in compound sentences, complex sentences, prepositions, etj, duke dalë nga tipi i ushtrimeve tradicionale që jepen nëpër tekste dhe duke praktikuar formate të reja ushtrimesh ku të përfshihen këto aspekte gramatikote, duke e parapërgatitur nxënësin për ato çka do trajtohen në provimin me zgjedhje të Maturës Shtetërore. Mësuesi duhet të fokusohet në anën praktike të zgjidhjes së ushtrimeve.
- Funksionet gjuhësore duhet të trajtohen në mënyrë sa më të larmishme duke përdorur situata nga të gjitha fushat e jetës, por duke ruajtur formatet dhe shprehjet që jepen në tekstet mësimore. Në to duhet të ndihet rëndësia dhe ndikimi i madh që ka të mësuarit dhe të folurit e gjuhës angleze.
- Përsa i përket të shkruarit mësuesi duhet ushtrojë nxënësit e tij që të dinë të organizojnë fjalët në fjali, fjalitë në paragrafë dhe paragrafët në një ese. Gjithashtu mësuesi duhet të përgatisë nxënësit që të dinë të përmbledhin me shkrim një përvojë personale duke përshkruar ndjenjat dhe reagimet e tij në një tekst koherent.

II. KONCEPTET BAZË , NJOHURITË DHE SHPREHITË

Në provimin e maturës shtetërore nxënësit do të testohen dhe vlerësohen për:

a)Të kuptuarit me shkrim – Reading Comprehension

Vlerësimi i këtij komponenti do të bëhet mbi bazën e një teksti të panjohur mbi të cilin do të ndërtohen ushtrime kuptimore.

Nxënësi duhet të jetë në gjendje të lexojë dhe të kuptojë në mënyrë globale tekste për të gjetur informacionin e kërkuar; për të mbledhur informacionet që i kërkojnë nga pjesë të ndryshme të një teksti, apo tekste të ndryshme për të përmbushur një detyrë të caktuar.

Në një pjesë leximi nxënësi duhet të dallojë faktin nga opinioni, duke përdorur informacion të saktë, argumenta dhe pikëpamje që të jenë koherente.

Është e rëndësishme që ai të dallojë informacionin thelbësor nga ai i parëndësishëm, duke vendosur kritere për gjykim, analizë dhe nxjerrje konkluzionesh rreth një çështje të caktuar.

Në mënyrë të përmbledhur kjo aftësi përfshin:

- kuptimin global të tekstit,
- kuptimin selektiv: gjetjen e informacioneve specifike,
- përgjigjen e pyetjeve rreth përmbajtjes së tekstit,
- kuptimi i thelluar: gjetja e të pashprehurës ose të nënkuptuara, qëndrimin e autorit, etj.,
- plotësimi i ushtrimeve leksikore rreth tekstit,
- kryerja e ushtrimeve gramatikore rreth tekstit.
- Gjetjen e fjalëve referuese (kujt i referohet ky përemer ne fjali)
- Formimin e një kuptimi të përgjithshëm.
- Marrja dhe përzgjedhja e informacionit të duhur brenda një teksti të caktuar.
- Reflektimi mbi përmbajtjen e një teksti dhe vlerësimi se sa me vend janë disa elemente të informacionit.
- Zhvillimi i aftësisë interpretuese duke bërë një përfundim logjik.
- Gjetja e një informacioni sinonim.
- Zhvillimi i aftësisë interpretuese duke bërë identifikimin dhe paraqitjen e elementëve provues.
- Reflektimi mbi përmbajtjen e një teksti duke u bazuar mbi disa vlera dhe bindje për të dhënë një gjykim në lidhje me moralin e një historise.

b)Të shprehurit me shkrim- Writing

Për vlerësimin e kësaj aftësie nxënësi duhet të paraqesë një produkt të shkruar prej 100-150 fjalësh, në të cilin të zhvillojë një temë mbi çështje me interes të përgjithshëm, e dhënë në pjesën e panjohur ose jashtë saj.

Të shprehurit me shkrim përfshin:

- të shprehurit me shkrim për një gamë të gjerë temash të njohura e komplekse që janë trajtuar në librat e katër viteve.
- një produkt të shkruar saktë nga ana gramatikore dhe të strukturuar mirë (letër formale ose joformale, paragraf përshkrues).
- lidhjen në mënyrë koherente të informacioneve nga burime të ndryshme,
- shprehjen e pikëpamjeve në formë të argumentuar,
- përdorimin e një repertori të gjerë leksikor,
- koment me shkrim për probleme të ndryshme.
- Të dijë të organizojë mirë përmbajtjen e punës me shkrim duke qenë gjithnjë në koherencë me temën e dhënë.
- Të vendosë dhe të ruajë një këndvështrim të vetin dhe origjinal për temën mbi të cilën do shkruajë.
- Të dijë të shkruajë pragrafë të plotë në të cilët të ketë detaje dhe informacione specifike për temën e dhënë.
- Të dijë të ruajë rendin e mendimeve në gjithë pjesën e shkruar.
- Të përdorë tipe dhe gjatësi të ndryshme fjalish.

c) Njohuritë

Në këtë program njohuritë kryesore që nxënësi ka marrë gjatë katër viteve të shkollës së mesme, janë të dhëna përmes **fushës tematike** të mëposhtme, e cila është e ndarë në linja dhe nënlinja sipas tematikës së zhvilluar në shkollën e mesme dhe **elementeve gramatikorë**, të cilat zhvillohen në mënyrë spirale gjatë katër viteve të shkollës së mesme dhe të detajuara në program.

d) Shprehitë

Shprehitë kryesore që nxënësi ka fituar gjatë katër viteve të shkollës së mesme janë dhënë përmes **akteve dhe funksioneve komunikative**. Të ilustruara me shembuj ato tregojnë se cilat janë shprehitë kryesore që një nxënës ka fituar përmes realizimit të programit të shkollës së mesme dhe që është i aftë të shprehë.

Tipet e ushtrimeve të rekomanduara për çdo fushë

FUSHAT

1 Të kuptuarit me shkrim (Reading comprehension)

- pyetje mbi përmbajtjen e tekstit
- ushtrime me vende bosh
- ushtrime me zgjedhje fjalësh ose frazash
- ushtrime me përgjigje po/jo
- ushtrime me e vërtetë/e rreme
- ushtrime me disa alternativa

- gjetja e një informacioni në një tekst
- gjetja e idesë kryesore

2. Fjalor dhe Gramatikë (Vocabulary and Grammar)

- Ushtrime me zëvendësim
- Ushtrime transformimi
- Ushtrime me shumë zgjedhje/ alternativa
- Ushtrime me plotësime vendesh bosh
- Ushtrime me ndërtim fjalish
- Ushtrime me bashkim fjale me kuptimin
- ushtrime me gjetje gabimesh, bashkim funksioni me strukturën përkatëse, etj.

3. Të shkruarit (Writing)

- radhitje paragrafësh sipas koherencës
- letër / mesazh,
- hartim i një dialogu për një temë të caktuar
- përmbledhje, koment
- ese e shkurtër
- radhitja e fjalive në paragraf
(ushtrimi i tipit *ese e shkurtër* të jepet në njërin nga testet)

Ndarja e peshës sipas fushave

FUSHAT	Përqindja
1 Të kuptuarit me shkrim Reading comprehension	30 %
2. Fjalor dhe Gramatikë Vocabulary and Grammar	50 %
3. Të shkruarit Writing	20 %

III. PËRMBAJTJA E PROGRAMIT

Fushat tematike dhe leksiku

Kjo rubrikë e programit grupon linjat kryesore si edhe nënlinjat, të cilat janë të përbashkëta për mësimin e gjuhës së huaj. Ato reflektojnë interesat dhe motivimin e nxënësve dhe rrokin gjithë sferën e marrëdhënieve *familje-shoqëri-nxënës*; sferën publike dhe sferën profesionale si edhe aspektin kulturor e qytetërimin.

Përmbajtja tematike është mbështetur në programin e zhvilluar gjatë katër viteve të shkollës së mesme si edhe në tekstet shkollore për gjuhën angleze. Tematika e mëposhtme, e parashikuar për provimin e maturës, do të përfshijë temat bazë (sipas kurrikules) dhe nëntema të marra nga kurrikula dhe tekstet.

Temat janë formuluar në mënyrë përgjithësuese e jo sipas titujve të teksteve dhe përfshijnë ato njohuri të cilat janë zhvilluar përmes mësimëve.

1. Every day life

Types of music and preferences in music

Eating out. Restaurants, menus, bills.

Adventures, accidents, incidents.

2. The World around us

Lives of famous people

Customs around the world.

Environmental issues.

3. The world of learning and work

School rules

Teachers and students; roles and responsibilities.

English and the world of business.

Job interviews.

4. Personal and social life

Friendship and relationship

Being a teenager; special interests, problems, peer pressures.

Equal opportunities, equal rights for men and women, young people and adults.

5. The world of communication

Computers now and in the future

Written media (Advertisements, magazines and written press)

Electronic media (TV and its programs).

6. The international world

British and American language

British and American costumes and traditions

Leksiku

Programi ka karakter tematik. Në bazë të temës, përzgjidhet dhe integrohet në të përmbajtja leksikore e domosdoshme, aktet gjuhësore si edhe strukturat gramatikore që mundësojnë realizimin e komunikimit. Nxënësi duhet të zotërojë një repertor leksikor të mjaftueshëm për të përballuar me sukses dhe për t'u shprehur lirshëm me shkrim.

Aktet dhe funksionet komunikative

Sugjerohen aktet dhe funksionet e mëposhtme, të cilët shërbejnë si mënyrë orientuese për hartimin e testit dhe vlerësimin e nxënësve. Aktet dhe funksionet komunikative japin shprehitë kryesore që nxënësi ka fituar gjatë katër viteve të shkollës së mesme.

◆ **Asking for and giving specific information:**

e.g. What is the population of England?

◆ **Expressing and eliciting preferences:**

I'd rather... I prefer, I like better, ("English for you 2"- mësimi 1)

◆ **Expressing obligation, permission and prohibition:**

Should, shouldn't, must, have to and can. ("English for you 3"- mësimi 5;"English for you 1"-mësimi 11;" English for you 2"- mësimi 3)

e.g. Students have to wear a uniform. I must study hard. You mustn't tell lies.

◆ **Giving advice:**

should, can, could, and why don't you. (" English for you 3"-mësimi 20)

e.g. You could read a book instead. You shouldn't drive so fast.

◆ **Expressing opinions:**

in my opinion... I think...I believe...and for me...("English for you 3"- mësimi 12)

◆ **Expressing approval and disapproval:**

e.g. It seems like a good idea; I approve of that; Ok its fine etc.
(" English for you 2"-mësimi 1)

◆ **Expressing interest:**

(" English for you 3"-mësimi 20)

e.g. I'm interested in.. I'm fascinated by...I think..., I believe.. In my opinion... I would say...

◆ **Agreeing and disagreeing (politely):**

e.g. I agree (100%) with you / I approve the idea / I think you are right. I totally disagree with your....etc. (" English for you 3")

◆ **Expressing possibility, probability, certainty:**

Might,must,can't,may (" English for you 3"- mësimi 15)

e.g. He might have gone out.

◆ **Indicating contrast.**

(" English for you 3"-mësimi 4)

e.g. Although it was cold we enjoyed the excursion.

◆ **Stating hypotheses.**

(" English for you 2"-mesimi 6,11)

e.g. if he had enough money.

Elemente dhe struktura gramatikore

Për një komunikim të saktë nga ana gramatikore, si me gojë ashtu edhe me shkrim, sugjerohen strukturat dhe çështjet gramatikore të mëposhtme:

◆ **Verb tenses:**

Simple present/ past, future, present/past continuous, present/past perfect tense.
(" English for you 1"; "English for you 2"-mësimi 1; " English for you 3"-mësimi 6,8)

◆ **Gerund and infinitive verb patterns:**

(with like, dislike, love, would love hate, prefer)
("English for you 1"-mësimi 2; "English for you 3"-mësimi 14; "English 4"-mësimi 1)

◆ **Reported speech** (positive, interrogative and imperative forms)

(" English for you 1"-mësimi 13; " English for you 3"-mësimi 18)
e.g. She said that she wanted to go to Paris. She told me to go out.

◆ **Active and Passive Voice:** (present, past, future, perfect)

(" English for you 1"-mësimi 8; " English for you 2"- mësimi 5,7)
e.g. She was born in 1985; The Eiffel Tower was built in Paris.

◆ **Conditionals:**

e.g. If I won lottery, I would build a house.
subjunctive statements.

(" English for you 3" mësimi 7; " English for you 1"-mësimi 12; " English for you 2" mësimi 6)

e.g. I wish I were rich! I wish I had more money!

◆ **Modal verbs**

May (to express permission) Might (to express possibility)

Can (to express ability or permission)

Must/ have to/ should/ ought to/ had better-to express obligation

(" English for you 3" mësimi 15; " English for you 1"-mësimi 11)

◆ **Adjectives:** Degrees of comparison

Adjective + preposition combinations.

(" English for you 3" mësimi 18)

e.g. Keen on / interested in / good at / proud of.

◆ **Articles:**

Definite and indefinite article. Special cases;

(" English for you 1" mësimi 10)

e.g. Spain, France, Italy, Albania BUT the US, the United Kingdom,

◆ **Prepositions and Idiomatic prepositional expressions**

Common phrasal verbs with: e.g. look , get , give, take, put, make
(“ English for you 1”)

◆ **Adverbs and Adverbial clauses** of purpose, time, reason, concession, manner, and place using the following connecting words; when, while, after, before, although/even though / even if, where, wherever, as...as, since, because, therefore, such.. that, so... that, so that, in order to/ that, however, despite/ in spite of. (“ English for you 3” mäsimi 12)